



Pak para nisjes drejt Sllovenise, presidenti i FSHF-se Armando Duka ka dhene nje prononcim per Albaniasoccer. “Mua me duket gabim te themi takimet , ne futboll duhet te fokusohesh te ndeshja e radhes pa menduar per ate pasardhese ne Islande. Sllovenia eshte nje skuader e mire, ka ne perberjen e saj lojtare cilesore, luan ne shtepine e vet dhe luan shansin e fundit per kualifikim. Duke patur parasysh keto eshte nje malore jo e lehte per ne. Ne jemi te pregatitur per ta ngjitur kete malore e cila na hap rrugen drejt majes. Deshiren e motivimin madje i kemi maksimale. Do kemi shume mbeshtetje nga tifozat tane ndoshta gjysmen e stadiumit. Le te presim e te shohim. Ndeshje shume e veshtire, por jo e pamundur. Djemte nuk duhet te vihen nen presion, ata duhet te luajne futboll. Zoti na shperblefte me nje fitore”, ka deklaruar Duka.